



## **Deklarata e Lirimit nga Përgjegjësia dhe rregullat e Privacy**

(Ju lutem lexoni me kujdes pasi ndikon në të drejtat tuaja ligjore)

**Supozimi i shprehur i rrezikut:** Unë pajtohem dhe pranoj se pjesëmarrja në Tirana Trowdown, përfshin edhe rreziqe të ndryshme përsa i përket dëmtimeve, rrëzime që mund të rezultojnë në lëndime të rënda, lëndime për shkak të pakujdesisë nga ana ime ose nga njerëzit e tjerë përreth meje, lëndim për shkak të përdorimit jo të rregullt të pajisjeve, çdo dëmtim serioz personal ose përkeqësim i shëndetit (p.sh. muskulo-skeletor, kardiovaskulare, neurologjike etj.) ose ndonjë rrezik për dëmtim të pronës.

Jam dakord dhe e pranoj që ndonjë nga këto rreziqe të lartpërmendura mund të rezultojë në lëndim serioz ose vdekje për mua por pohoj se jam i informuar dhe plotësisht i vetëdijshëm për rreziqet e randomizës dhe e pranoj se Tirana Trowdown, nuk mban përgjegjësi në rast të ndonjë lëndimi ose vdekjeje ose dëmtimi e pronës për shkak të mosfunksionimit dhe/ose dëmtimit të vendit të ngjarjes.

Unë me dëshirë dhe shprehimisht marr përgjegjësinë e plotë për rreziqet ndaj të cilave jam i ekspozuar dhe pranoj përgjegjësinë e plotë për çdo lëndim, dëmtim ose vdekje që mund të rezultojë nga pjesëmarrja në Tirana Throwdown 2023.

Deklaroj me përgjegjësi të plotë që nuk kam dëmtime fizike apo sëmundje që do të rrezikojnë veten apo të tjerët dhe nuk vuaj nga ndonjë gjendje shëndetësore e cila mund të përkeqësohet nga pjesëmarrja në Tirana Throwdown 2023.

**Informacion mjekësor:** Unë shprehimisht pranoj të marr ndihmën e parë dhe/ose ndonjë trajtim mjekësor që konsiderohet i nevojshëm nga çdo personel mjekësor në rast të një lëndimi, aksidenti ose sëmundjeje gjatë pjesëmarrjes sime në Tirana Trowdown 2023. Unë e pranoj gjithashtu se Tirana Throwdown, nuk është e detyruar të ofrojë trajtim mjekësor të mëtejshëm.

**Dëmshpërblimi:** Unë pranoj dhe kuptoj rreziqet e përfshira në aktivitetet e ofruara nga Tirana Trowdown. Prandaj, unë marr përgjegjësi financiare dhe pranoj përgjegjësi për çdo lëndim që mund t'i shkaktoj vetes dhe/ose për çdo dëmtim ose vdekje që mund t'u shkaktoj të tjerëve dhe/ose për çdo dëmtim të pronës të shkaktuar nga unë.

**Imazhe/Video:** Unë i jap Tirana Trowdown, dhe të gjithë personave ose personat juridikë të autorizuar prej tyre, lejen për të fotografuar, incizuar dhe transmetuar foto ose video të miat, si dhe ti publikojnë çdo foto ose video/film timin në faqen e tyre të internetit si dhe të përdorin çdo material tjetër promovues dhe edukativ pa kompensim ose shpërblim. Përdorimi i imazheve dhe videove/filmave të marra nga unë nuk do të përdoret për asnjë qëllim tregtar pa pëlqimin paraprak me shkrim të Tirana Throwdown.

**Ligji - Juridiksioni:** Kjo Marrëveshje do të trajtohet dhe do të interpretohet sipas ligjit shqiptar. Të gjitha mosmarrëveshjet ose konfliktet që lindin nga kjo marrëveshje, do të nënshtrohen juridiksionit ekskluziv të Gjykatave kompetente të Republikës së Shqipërisë.

Unë \_\_\_\_\_ kam lexuar me kujdes dhe e kam kuptuar se duke nënshkruar këtë Formular, po kufizoj disa nga të drejtat e përmendura më sipër.

Emër Mbiemër – Nënshkrimi

( \_\_\_\_\_ )

Data e dorëzimit

( \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_ )